



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** me datë **08.09.2025** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve dhe kriterëve të zbatimit të masës së sigurimit personal, e caktuar me vendimin Nr. 82, datë 06.08.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ndaj personit nën hetim **Soni Pepa alias Vilson Pepa**”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, bazuar në nenet 112, 228, 229, 230, 238 dhe 248 të K.Pr.Penale, me vendimin nr. **90**, datë **09.09.2025**, vendosi:

1. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues ‘*Arrest në burg*’ e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale e caktuar me vendimin Nr. 82, datë 06.08.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ndaj personit nën hetim: **Soni Pepa alias Vilson Pepa** si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “*Trafikimi i narkotikëve*” e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të organizatës kriminale dhe “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a, 28/1, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale*” e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të organizatës kriminale, parashikuar nga neni 287/1 gërma “b” dhe 28/1 të K.Penal, “*Organizata kriminale*” në formën e pjesëmarrjes, parashikuar nga neni 333, paragrafi 2 i K.Penal, “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*” parashikuar nga neni 334 pika 1 i K.Penal.
2. Urdhërohet Policia Gjyqësore, që personi nën hetim **Soni Pepa alias Vilson Pepa**, të dërgohet menjëherë në institucionin e paraburgimit, për të qëndruar aty në dispozicion të organit procedues.
3. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe policia gjyqësore për zbatimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar brënda 5 ditëve, nga njoftimi i vendimit të gjykatës

Tiranë, më datë 09.09.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar